



**Dr. Redvin Marku**

**Lektor**  
**Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë**  
**Tirana Business University College**

Dr. Redvin Marku është diplomuar në Bachelor për Financë-Kontabilitet në Universitetin e Tiranës; Master në Financë në Universitetin e Tiranës, si dhe Doktor i Shkencave në Ekonomi, pranë Universitetit të Tiranës.

Dr. Marku ka një përvojë mbi 13 vjeçare në mësimdhënie në nivel universitar, si dhe po aq vite eksperiencë profesionale në sistemin fiskal shqiptar, pranë institucioneve të ndryshme private dhe publike, në çështje që lidhen me tregtarët dhe shoqëritë tregtare etj. Ai ka publikuar shumë artikuj shkencorë në revista të njohura shkencore, brenda dhe jashtë vendit.

Fokusi i ekspertizës profesionale është në fushën e kontabilitetit dhe financave të shoqërive tregtare. Prej vitit 2008 është i angazhuar në konsulencën fiskale dhe kontabël si dhe në hartimin dhe këshillimin e legjislacionit fiskal aktual në Shqipëri, ka marrë pjesë në grupe pune të ndryshme për hartimin e politikave fiskale si dhe këshilltar pranë shoqatës së Biznesit të Vogël dhe të Mesëm në Shqipëri. Ai ka ekperiencë të ndryshme pune në shoqëri tregtare shqiptare si: Posta Shqiptare sh.a. si edhe Mogo Albania sh.a. në pozicione manaxheriale. Ai është themelues dhe drejtues i studios së konsulencës fiskale dhe kontabël “Redmark” me fokus ndërmarrjet e vogla e të mesme si dhe trajnues në veprimtari të ndryshme të organizuara nga OJF dhe organizata të ndryshme, me fokus raportimin financiar dhe hartimin e planeve të biznesit për biznese Start Up. Ai zotëron titullin Kontabilist i Miratuar dhe Auditues i Brendshëm.